



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Prilijeno: 28.03 20 24		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01-	16924	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	28.03.2024
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi – Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Planit në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
Lënda:	Raport nga procesi i konsultimit publik nga Projekt Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. MEHDI ZEJNULLAHU” në Lipjan.

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e Projekt Statutit të QKMF-së Lipjan dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Projekt Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. MEHDI ZEJNULLAHU” në Lipjan

Ku është publikuar edhe njoftimi me bashkëlidhjen e konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik ky dokument si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës si dhe në platformen e konsultimeve publike të Qeverisë së Kosovës.

Shih linqet: <https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42317>

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=670263618461323&set=pb.100064330733832.-2207520000&type=3>

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike ka publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 11.03.2024 për mbajtjen e konsultimit-debatit publik të Projekt-Statutit të QKMF-së në Lipjan, njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës.

në linkun:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/03/Njoftim-per-Debat-Publik-Projekt-Statuti-i-QKMF-se-shqip.pdf>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 18.03.2024 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora 10:00-11:30

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/news/debat-publik-per-projekt-statutin-e-qkmf-se-ne-lipjan/>

Nën kryesimin e dejtorit për Shëndetësi dhe Përkudjesje Sociale, Shkelzen Hajdini, njëherit edhe kryesues i komisionit për hartimin e këtij Projekt Statuti u hap takimi me ç`rast ai ka përshëndetur të gjithë të pranishmit duke i falenderuar për pjesëmarrje se projekt Statuti I Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” Lipjan bëhet duke u bazuar edhe ne shkresën e Ministrise së Shëndetësisë të datës 24.01.2024 të cilat kanë kerkuar nga Komunat që të gjitha institucionet e KPSH-së të cilët deri më tani nuk e kane aprovuar formen unike të statutit te QKMF-se, duhet të aprovojnë me qenë se është njeri prej indikatorëve që gjatë vitit 2024 do të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Projekt-Statuti i QKMF-së është hartuar nga grupi punues i themeluar me Vendim të Kryetarit të Komunës duke u bazuar në draftin unik të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe i njëjti i është nënshtruar procedurave të konsultimit publik në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Ai po ashtu ka prezantuar edhe komisionin në përbërje:

1. Shkelzen Hajsini- Drejtor i Drejtorisë -Kryesues
2. Dr.Agim Krasniqi– Drejtor i QKMF-së zv. Kryesues
- 3.Dr.Mirjeta Cakolli –QKMF- anëtare
4. Dr.Luftim Bresa –QKMF-anëtarë
5. Dr. Izer Sinani –QKMF anëtarë
- 6.Dr.Gazmend Qerkini-QKMF anëtarë
7. Dr. Besnik Rashiti -QKMF anëtarë
8. Albert Mustafa –DSHPS anëtarë
9. Flora Budakova- QKMF anëtare
10. Taipe Zogiani QKMF-anëtare
- 11.Islam Kaleshi- Zyra Ligjore anëtarë-
12. Agim Murtezi- Këshilli I pacientëve anëtarë

Duke e prezantuar projekt Statutin QKMF-së, Shkelzen Hajdini drejtor i Shëndetësisë dhe Përkudjesjes Sociale para të pranishmëve ka theksuar me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit. Gjithashtu me këtë document do të bëhet edhe zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë, ka thënë ndër të tjera drejtori Hajdini.



Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast kryesuesi Hajdini ka theksuar se me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse.



Nga ana tjetër qytetarët e pranishëm paten mundësi që të japin kontributin e tyre përmes sygjërimeve për finalizimin e këtij dokumenti në mënyrë që të jetë jetë jetë sa më i kompletuar dhe gjithëpërfshirës.

Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, lidhur me **Projekt Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. MEHDI ZEJNULLAHU” në Lipjan**

Gjatë këtij debati ka pasur edhe angazhime nga të pranishmit ku është diskutuar për çështjet të ndryshme dhe kanë kërkuar sqarime rreth këtij dokumenti.

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Projekt Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. MEHDI ZEJNULLAHU” në Lipjan	Tha se me UA për shërbimet shëndetësore në KPSH mundësohet vetëm specialisti i pedodoncisë dhe preventivës por jo i ordodoncisë. Andaj, ai kërkoj të konsiderohet largimi i këtij shërbimi nga draft stauti ngase MSh mund të mos e aprovon nje shërbim i cili nuk është i lejuar me legjislacion për KPSH.	Dr.Agim Krasniqi	Komisioni u përgjigj se vërejtja është me vend dhe propozimi u aprovua.	Komenti u pranua plotësisht
Projekt Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. MEHDI ZEJNULLAHU” në Lipjan	Ka pyetur për dallimin në mes të shërbimeve Emergjente dhe Urgjente në QKMF dhe po ashtu pyeti nëse janë të përfshirë mekanizmat shendetesor si një trup për çështje të caktuara.	Makfire Shamolli	Komisioni nuk ka pranuar komentin që të kemi dy shërbime edhe të urgjences edhe të emergences sepse në KPSH ofrohet vetëm shërbimi i Urgjencës.	Komenti nuk u pranua

			Ndërsa në Nivelin spitalor shërbimi i emergjencës.	
Projekt Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. MEHDI ZEJNULLAHU” në Lipjan	Ka kërkuar të përfshihen në këtë Statut edhe shërbimet e kujdesit të integruar dhe menaxhimit të cilesisë.	Dr. Merita Shehu	Komisioni, pranoj koemntin dhe informoj se këto shërbime do të reflektohen në Statut.	Komenti nuk u pranua plotësisht
Projekt Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. MEHDI ZEJNULLAHU” në Lipjan	Ka pyetur se kush duhet t'i formoj komisionin dicitplinor dhe komisionin për ankesa dhe të njejtat të janë të përshkruara në këtë Statut	Vlora Krasniqi,	Komisioni pranoj komentin dhe u pegjigj duke spjeguar se QKMF-ja i formon por në çiftëse edhe Kryetari i Komunës është në rregull.	Komenti nuk u pranua plotësisht

Komente përmes postes elektronike nuk ka pasur

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 15 pjesëmarrës, prej tyre femra 7 dhe 8 meshkuj.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
15-30 ditë pranohen komentet		15
15- 30 ditë pranohen komentet		

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike

Shtojcë: Lista e pjesëmarrësve

